

VENDIM
Nr. 195, datë 3.8.2022

**MBI KËRKESËN E OSSH SHA, LIDHUR ME RISHIKIMIN E VENDIMIT TË
BORDIT TË ERE-s NR. 133, DATË 6.6.2022**

Në mbështetje të nenit 16, si dhe nenit 20, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; nenit 6.2, të pjesës VI të “Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016, e ndryshuar; nenit 33, pikat 2 dhe 3, e ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1379/10 prot., datë 2.8.2022, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi kërkesën e shoqërisë OSSH sh.a. për rishikimin e vendimit të Bordit nr. 133, datë 6.6.2022”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 133, datë 6.6.2022, Bordi i ERE-s vendosi një shtesë në pjesën II “Dokumentacioni i kërkuar për aplikimin e një lidhje të re”, në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE-s, e ndryshuar.

- Shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., ka paraqitur pranë ERE-s, kërkesën për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 133, datë 6.6.2022, me anë të shkresës me nr. 6438 prot., datë 5.7.2022, protokolluar në ERE me nr. 1020/1 prot., datë 5.7.2021. Në kërkesën e saj, shoqëria OSSH sh.a. citon se:

- Ligji i sektorit ka autorizuar operatorin e licencuar në shpërndarjen e energjisë elektrike, OSSH sh.a., në këtë rast, për të propozuar miratimin e rregullores për lidhjet e reja, përfshirë këtu edhe ndryshimet përkatëse në rregulloren e miratuar më parë. Rezulton se iniciues i ndryshimeve në rregullore është ISHTI-ja, një institucion që jo vetëm nuk ka të drejtën e propozuesit referuar ligjit nr. 43/2015, por për më tepër nuk përmendet në asnjë nen të këtij ligji.

- Gjithashtu, OSSH sh.a., shprehet se nuk i është kërkuar mendim lidhur me propozimin e ardhur nga ISHTI-ja dhe nuk është ftuar si palë drejtpërdrejtë e interesuar, por është gjendur në kushtet e një vendimmarrje të cilën e vlerëson të padrejtë në aspektin procedural.

- OSSH sh.a., shprehet se vendimi i ERE-s është i padrejtë edhe për faktin se ka vendosur të propozojë ndryshimin në rregullore, duke shtuar një pikë e cila nuk ka qenë kërkesë e asnjë pale të përfshirë. Në shkresën iniciuese të këtij procesi, si dhe në vendimin për fillimin e procedurës të ERE-s, përmbajtja e pikave të cilat po trajtoheshin me qëllim shtimin e tyre në rregullore, janë tërësisht të ndryshme nga vendimi përfundimtar. Në këtë kontekst, ERE shprehet për diçka që nuk i është kërkuar dhe tërësisht jashtë objektivit të pretenduar.

- Lidhur me legjitimin e ISHTI-t si palë e interesuar në kuptim të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, 17.6.2016, në kuptim të nenit 5 (“Përkufizime”), pika 23 me palë të interesuar do të kuptojmë “një person që merr pjesë në një procedurë të caktuar të ERE-s”. Për sa përcaktuar në këtë dispozitë me vendimin nr. 60, datë 29.4.2016, Bordi i ERE-s vendosi: “Fillimin e procedurave për shqyrtimin e drafttregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”. Me shkresën nr. 350 prot., datë 3.5.2016, “Lidhur me draftet e akteve nënligjore në proces miratimi nga ERE”, ERE i ka dërguar për mendim, palëve të interesuara për draftin e “Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”.

- Në vijim të shkresës së sipërcituar, me shkresën nr. 350/1 prot., datë 20.5.2016, ISHTI-ja, ka shprehur dakordësinë e tij lidhur me drafttregulloren, duke parashtruar dhe disa komente përkatëse, të cilat u reflektuan në rregullore. Për sa evidentuar në pikën 4 të konstatimeve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016 “Për miratimin e rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, ERE e ka njohur ISHTI-n si palë të interesuar në procedurën e miratimit të “Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, duke e bërë pjesë me kërkesë për dhënie mendimi.

- Njohja dhe përfshirja e Inspektoratit si palë e interesuar që në krye të herës, pra kur drafti i rregullores, objekt i kërkesës së paraqitur përmes shkresës nr. 5393 prot., datë 30.8.2021, protokolluar në ERE me nr. 916 rot., datë 2.9.2021, ishte duke u shqyrtuar, bën që ISHTI-ja të legjitimohet si palë e interesuar dhe për nisjen e procedurës së re për trajtimin e kërkesave.

- OSSH sh.a. bën një lexim shumë të ngushtë të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, kur shprehet se ligji i sektorit ka autorizuar operatorin e licencuar në shpërndarjen e energjisë elektrike, për të propozuar miratimin e rregullores për lidhjet e reja, përfshirë këtu edhe ndryshimet përkatëse në rregulloren e miratuar më parë. Nëse do i referohemi edhe njëherë nenit 26 të rregullores së sipërcituar, vihet re që kjo dispozitë rregullon njëkohësisht disa institute ligjore (hartimin, rishikimin dhe miratimin) të cilat në tërësi përbëjnë procedurën administrative e cila konkludohet me miratimin e akteve nënligjore me statusin rregullore, udhëzim, metodologji dhe licencë. Arsyeimi i ndjekur nga ana e OSSH sh.a., se për të tria këto faza të procedurës administrative, do të ishte vetëm ky subjekt i legjitimuar si propozues është tërësisht i gabuar. Përfshirja e palëve të tjera në cilëndo çështje dhe sigurimi i së drejtës së tyre për t’u dëgjuar është një garanci e shtuar në sigurimin e një procedure administrative të ligjshme dhe transparente.

- Për sa më sipër edhe në kuptim të nenit 33, pika 3, të “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, sqarohet se: “Organi publik që zhvillon procedurën administrative, me kërkesë apo kryesisht, përfshin si palë në procedurë çdo person tjetër, të përcaktuar ose lehtësisht të përcaktueshëm, të ndryshëm nga ato të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, të cilin, rezultati i procedurës administrative mund ta cenojë në të drejtat apo interesat e tij të ligjshëm”.

- Përfshirja e palëve të interesuara, ritheksohet edhe njëherë në pikën 6 të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, ku përcaktohet se: “Të gjitha palët e interesuara do të dërgojnë komentet e tyre me shkrim për projekt aktin brenda afateve të përcaktuara nga ERE...”.

- Gjithashtu në kuptim të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, neni 9, Palët e interesuara në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik kanë të drejtë: b) t’u propozojnë organeve publike fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e projektakteve, sipas planit vjetor të procesit të vendimmarrjes, publikuar nga organi publik, në përputhje me parashikimet e shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji.

- Nga ana e OSSH sh.a., vendimmarrja e ERE-s për fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së ISHTI-t për disa ndryshime në rregullore, megjithëse është njoftuar rregullisht, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, nuk është goditur apo pretenduar nga ana e ankuesit mungesa e legjitimitetit të ISHTI-t në adresimin e një kërkeje për ndryshim akti në ERE.

- ERE, me anë të shkresës me nr. 916 prot., datë 16.12.2021, dërgoi shkresën për “Marrije mendimi” të një sërë subjektsh mes të cilave dhe pranë OSSH sh.a., të cilët në vijim kanë përcjellë në ERE opinionin e tyre dhe janë bërë pjesë edhe të seancës dëgjimore të datës 14.2.2022, në lidhje me diskutimin për propozimet e ISHTI-t, sa i përket disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren e lidhjeve të reja në sistemin e shpërndarjes”, të miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i

ndryshuar. Për sa më sipër pretendimi i shoqërisë OSSH sh.a., se nuk i është kërkuar mendim lidhur me propozimin e ardhur nga ISHTI-ja dhe nuk është ftuar si palë drejtpërdrejtë e interesuar, por është gjendur në kushtet e një vendimmarrje, nuk qëndron.

- Faza e fillimit të procedurës administrative ka si qëllim vetëm vendosjen e marrëdhënieve juridike administrative ndërmjet organit publik dhe palëve konkrete dhe jo zgjidhjen përfundimtare të çështjes për këtë arsye OSSH sh.a., nuk është vënë në kushtet e ndonjë vendimmarrjeje finale, ndryshe nga sa shprehet.

- Shtesa në pikën 2.1, 2.2, 2.3 nuk bën gjë tjetër veçse kërkon që në kuptim të një aplikimi për lidhje të re të zbatohet edhe legjislacioni në fuqi përfshirë aktet ligjore dhe nënligjore të organeve të ngarkuara me ligj. Sa më sipër gjendet e parashikuar edhe në pikat 1.7 dhe 1.9 të “Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, të miratuar vendimin nr. 166, datë 10.10.2016. Pikat 1.7 dhe 1.9 sikurse tani edhe pikat 2.1, 2.2 dhe 2.3 të shtuara me vendimin për të cilin është kërkuar rishikim nga OSSH sh.a. vendosin gjithashtu detyrimin për vlerësimin e një aplikimi nga Operatori bazuar ndër të tjera edhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave. Pika 1.9 sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016 “Për miratimin e rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, e ndryshuar, gjithashtu parashikon detyrimin që aplikanti, mbi bazë të akt-marrëveshjeve dypalëshe me Operatorin e Shpërndarjes duhet të respektojë: ndër të tjera të gjitha normat e sigurimit teknik në përputhje me standardin ISOO dhe të ligjeve, akteve nënligjore dhe rregullave në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e OSSH sh.a. lidhur me rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 133, datë 6.6.2022, “Mbi kërkesën e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar”.

2. Grupi i punës, të njoftojë OSSH sh.a. dhe palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti